

“Të drejtat e njeriut dhe dialogu ndërfetar janë mjetet më të mira për ti dhënë fund indiferencës dhe dhunës”.

NANË TEREZA



Kisha ting Jeta

ORGAN I PËRMUAJSHËM INFORMACIONI I METROPOLISË TIRANË-DURRËS Nr. 7 SHTATOR 2017 Çmimi 30 lekë



SHQIPËRIA KA TRE IPESHKVIJ TË RINJ

Kalendari Liturgjik

Tetor 2017

Engjëjt e Zotit

Ungjilli sipas Mateut 13,34-43

Imzot Gjergj Meta, Ipeshkëv i Rrëshenit	faqe 3
Fjala përshëndetëse e Ipeshkëv të sapo shuguruar Imzot Gjergj Meta	faqe 4
Imzot Giovanni Peragine, Ipeshkëv i Jugut të Shqipërisë.	faqe 5
Fjala përshëndetëse e Ipeshkëv të sapo shuguruar Imzot Giovanni Peragine	faqe 7
Imzot Simon Kulli, Ipeshkëv i Sapës.	faqe 7
Fjala përshëndetëse e Ipeshkëv të sapo shuguruar Imzot Simon Kulli	faqe 9
Skëlqesia e Tij Imzot George Frendo në XI vjetorin e shugurimit ipeshkëv	faqe 10
Homelia e Sh. T. Imzot Gjergj Meta, në përvjetorin e XI të shugurimit ipeshkëv të imzot Sh. T. George Frendo	faqe 11

Të gjitha këto Jezusi ia tha popullit në shëmbëlltyra dhe asgjë nuk i thoshte pa shëmbëlltyra ³⁵ që të plotësohej fjala e profetit: *'Do të flas në shëmbëlltyra, do të zbuloj gjëra të fshehura që nga krijimi (i botës).'*

Atëherë e shpërndau turmën dhe hyri në shtëpi. Nxënësit iu afruan dhe e pyetën: "Na e shtjello shëmbëlltyrën e egjërës së arës."

Ai u përgjigj:

"Ai që e mbjell farën e mirë, është Biri i njeriut. Ara është

bota. Fara e mirë janë ata që i përkasin Mbretërisë. Egjra paraqet ata që i përkasin Qoftëlargut. Armiku që mbolli egjërën është djalli. Korrja është mbarimi i botës. Korrtarët janë engjëjt. Siç mblidhet egjra e digjet në zjarr, kështu do të ndodhë në mbarimin e botës. Biri i njeriut do t'i dërgojë engjëjt e vet për t'i mbledhur në Mbretërinë e tij të gjithë ngashnjyesit dhe ata që bëjnë keq, e do t'i hedhin në furrë të ndezur, ku do të jetë vaj e kërcëllim dhëmbësh. Kurse të drejtët, atëherë, do të shndrisin porsi dielli në Mbretërinë e Atit të tyre. Kush ka vesh, le të dëgjojë!"



01 tetor – E DIELA e XXVI GJATË VITIT (A),

Sh. Tereza e Jezusit Fëmijë

02 tetor – Engjëjt e rojës

04 tetor – Sh. Françesku i Asizit

06 tetor – Sh. Bruno

07 tetor – Sh. Maria Virgjër e Rruzares

08 tetor – E DIELA e XXVII GJATË VITIT (A),

14 tetor – Sh. Kalisti

15 tetor – E DIELA e XXVIII GJATË VITIT (A),

Sh. Tereza e Avilës

16 tetor – Sh. Hedviga; Sh. Margarita M. Al.

17 tetor – Sh. Injaci i Antiokisë

18 tetor – Sh. Luka (Festë)

19 tetor – Sh. Gjon B., Isak J. e sh., Sh. Pali i Kryqit

22 tetor – E DIELA e XXIX GJATË VITIT (A)

24 tetor – Sh. Anton Maria Klaret

28 tetor – Sh. Simoni dhe Juda (Festë)

29 tetor – E DIELA e XXX GJATË VITIT (A)



Drejtor i përgjithshëm:

Imzot George Frendo

Kryeredaktor:

D. Marjan Lumçi

Sekretar:

Ferdinand Ndocaj

Redaksia:

Kolec Çefa
Ana Stakaj
Zef Skanjeti
Elidon Dodaj

Grafika:

Pjerin Sheldija

Foto: Pici

Adresa:

Katedralja e Shën Palit,
Bulevardi Zhan D'Ark,
Tiranë, Shqipëri

E-mail: kisha.jeta@gmail.com

www.kishadhejeta.com

Imzot Gjergj Meta, Ipeshkëv i Rrëshenit

Homelia e Shkëlqesisë së Tij Imzot George Frendo, në shugurimin ipeshkvor të Imzot Gjergj Metës si Ipeshkëv i Dioqezës së Rrëshenit.

Rrëshen, më 2 shtator 2017

Idashur vëlla dhe shok në rrugëtim, i dashur Gjergj: i ke zgjedhur ti leximet që sapo kemi dëgjuar. Fjalët që do të t'i drejtoj ty tani, dëshiroj që të jenë për ty, si edhe për mua, një meditim nëpërmjet tri personave për të cilat bëhej fjalë në këto tri lexime dhe kështu të mësojmë nga ta. Janë Isaia, Pali, dhe Pjetri.

Isaia është thirrur të jetë profet. Shpeshherë mendojmë se profeti është ai që parakallëzon të ardhmen. Por në fakt profeti është një person me një mesazh për të tanishmen, duke pasur parasysh situatën e tanishme dhe shenjat e kohës së tanishme; është dërguar prej Zotit dhe flet në emrin e Zotit, me një mision të veçantë: duhet ta qortojë popullin për gabimet e tij, por edhe t'i japë shpresë në momentet e vështira. Isaia dhe profetët kanë hasur momente të vështira. Ti je ende në "muajin e mjalitit"; ky muaj kalon, e do të vijë momente kur ndoshta do të ndihesh i vetmuar ose i keqkuptuar. Është mirë që në jetën tonë të përjetojmë edhe eksperiencën të tillë: të pranuar me shpirt të krishterë, na mësojnë për-vujtërinë dhe na detyrojnë t'i drejtohem Zotit e t'i themi: Ji ti, o Zot, fuqia ime!

Por Isaia është gjithashtu profet i shpresës. Në momentet më të vështira në historinë e popullit, ka qenë ai që i ka thënë popullit: Mos u tremb! Zoti është Emanuel, Zoti me ne. Ti vetë jeto me shpresë, por ki kujdes që të frymëzosh gjithmonë shpresën tek besimtarët që do të të besohen ty. Me një fjalim plot ankesave ose dënimeve i bën më shumë dëm Kishës sesa mirë. Predikimi ynë le të jetë gjithmonë dhe vetëm një lajm i mirë.



Isaia ve re se misioni profetik nuk është një mision i lehtë. Prandaj bërtet: "I mjeri unë..." Nuk jam i denjë! I dashur vëlla, të nxis që, si Isaia, edhe ti të vësh re se nuk je i denjë. Por si Davidi thuajti Zotit: "Kush jam unë, o Zot Hyj, dhe ç'është shtëpia ime, që ti më bërë të arrij deri këtu?" Kështu do të kuptosh gjithmonë sa bujar ka qenë Zoti me ty.

Pali ishte zgjedhur që të bëhej apostull i popujve. Personi i Palit paraqet një paradoks të madh. Imagjinoni Jezusin të vijë tek ne për një këshillë. Na thotë: "Dua të caktoj një person të

bëhet apostull i popujve. Çfarë mendoni për Palin?" Besoj se do t'i kishim thënë: "Zotëri, a po bën shaka? Pali? Ai farise fanatik, nga i cili të gjithë nxënësit e tu trembeshin edhe vetëm duke përmendur emrin e tij?" Por Zoti ynë nuk është njëxhuxh. Është Zoti që jep shpirtin e jetës edhe eshtrave të thatë dhe kalon nëpër dyer të mbyllura.

Pjesa që kemi dëgjuar në leximin e dytë nga Letra drejtuar Galatasve është krejt në kundërshtim me atë që vetë Pali besonte dhe predikonte si farise fanatik. Rrethprerja nuk vlen asgjë, as veprat e mira që bëjmë nuk vlejnë asgjë nëse nuk janë të frymëzuara nga feja. Nuk janë traditat tona që na bëjnë katolikë të vërtetë, por, thotë Pali, "feja që vepron me dashuri". Janë fjalë, i dashur vëlla, që ti ke caktuar si moto për stemën tënde, që në fakt do të thotë se do të të shoqërojnë dhe të frymëzojnë në udhëheqjen e dioqezës qetësishtë besuar ty. Të uroj që feja të jetë gjithmonë arsyeja e çdo nisme dhe i çdo aktiviteti, veçanërisht në marrëdhëniet e tua me popullin, sidomos me të varfërit, në mënyrë që në fytyrën e çdo personi që do të të afrojë të shohësh fytyrën e Jezu Krishtit. Kujtoji gjithashtu fjalët që kemi dëgjuar gjithmonë në Leximin e Dytë: "Krishti na liroi që të mbeteshim vërtet të lirë". Të lirë për të bërë atë që është e drejtë. Pa kompromis me persona të korruptuar, me persona që kërkojnë më shumë të shërbehen nga Zoti dhe nga Kisha sesa t'i shërbejnë Zotit dhe Kishës. S'kemi nevojë për privilegje. Duam vetëm të shërbejmë me "fe që vepron me dashuri".



Së fundi kemi figurën e Pjetrit. Është një mëkatar, i pakultuar, i dobët dhe frikacak, që nuk guxoi ta mbështesë Jezusin në atë moment kur Jezusi kishte më shumë nevojë për mbështetjen e tij. E mohoi për një, dy, tri herë. Megjithatë pastaj pranoi mëkatin e vet, qau, dhe tani e shpalli dashurinë e tij për Zotin.

Por ky tregim i bukur nga Ungjilli i Gjonit na paraqet gjithashtu zemrën e mëshirshme të Jezusit. Ai takohet me atë të cilit një ditë i kishte thënë "Ti je shkëmb!" Sipas logjikës sonë, tani Jezusi më mirë do t'i kishte thënë: "Ti vlen më pak sesa argjila dhe rëra! Nuk je shkëmb fare!" Por jo! Përkundrazi, Jezusi tani i jep Pjetrit rastin për të shndërruar mohimin e tij në një pohim dashurie. Për tri herë Jezusi e pyet: "A më do ti?" Dhe për tri herë Pjetri pohon me këmbëngulje dashurinë e tij për Jezusin.

Dhe vetëm pasi Pjetri pohon dashurinë e tij Jezusi i beson atë mision fisnik: "Kulloti qengjat e mia! Kulloti delet e mia!" Sepse kujdesi për delet nënkupton dhe kërkn dashuri. Vetëm dashuria na bën të denjë dhe të aftë të pranojmë dhe të kryejmë një mision që Zoti na beson. Vetëm dashuria, fort i dashur vëlla, na aftëson t'i njohim delet dhe të thërrasim secilën me emër. Vetëm dashuria na jep atë kurajo për ta kërkuar delen e humbur, dhe pasi ta kemi gjetur, nuk

e rrahim, as e qortojmë me fjalë dënimi, por e përqafojmë duke e çuar në vathë dhe duke e mbrojtur nga ujku.

I dashur vëlla, në misionin tënd baritor do të kesh, padyshim, mbështetjen e martirëve tanë, veçanërisht të atyre që ishin nga Mirdita ose kanë punuar në Mirditë: të lumët Dom Jak Bushati, Dom Mark Gjani, Marie Tuci, Anton Zogaj dhe veçanërisht Imzot Frano Gjini, që ka shërbyer si Ipeshkëv në Orosh (Mirditë). Për ta mbrojtur popullin që po torturohej nga komunistët, ai i ka shkruardy herë letër Enver Hoxhës, edhe duke rrezikuar jetën e vet. Në fakt, si përgjigje të vetme mori arrestimin dhe torturat më çnjerëzore. Para se ta pushkatonin tha këto fjalë të fundit: "Rrnoftë Krishti mbret, rrnoftë Shqipnia edhe pa ne".

Rasti i sotëm ka një domethënie shumë të veçantë për mua, për dy arsye. Së pari, sepse kjo është hera e parë që po bëj një kremtim kaq të veçantë dhe të rëndësishëm, shugurimine një ipeshkvi. Së dyti, sepse kandidati është ai i cili, deri para dy muajsh, ka qenë dora ime e djathtë në drejtimin e arqidioqezës Metropolitane të Tiranë-Durrësit si Vikar i Përgjithshëm. Prandaj fjala e parë që dua ta drejtoj ty, i dashur vëllai im Gjergj, është: Falënderit! Menjëherë pas emërimit tim si arqipeshkëv i Tiranë-Durrësit të

caktova si zëvendësin tim, dhe gjatë kësaj kohe të shkurtër (në fakt, vetëm shtatë muaj) kam gjetur në ty një person me të cilin kam pasur mundësi të këshillohem, të ndaj problemet e mia, dhe të bisedoj për shumë lloj argumentash. Nuk e di çfarë do të thuash ti për mua, por nga ana ime kam shumë gjëra për të cilat duhet të të jem mirënjohës.

Zoti të ka dhuruar shumë gjëra të bukura, ndër të cilat përmend zgjuarsinë tënde dhe një karakter që të bën një bari shumë të afrueshëm dhe të hapur për marrëdhënie të ngrohta. Përveç kësaj, edhe në Kishën tonë eprorët e tu, duke filluar me Imzot Rrok Mirdita, të kanë treguar një besim të madh dhe ke çuar përpara shumë detyra të rëndësishme. Por mos harro se çdo gjë që kemi është dhuratë. Çdo sukses në jetën tënde le të jetë rast për t'iu drejtuar Zotit duke i thënë: "Falënderit, o Zot, sepse më ke përdorur për ta zbatuar planin tënd". Gjithashtu çdo zhgënjim le të jetë për ty rast për të mësuar dhe përjetuar përvujtëri, dhe atëherë nguliti sytë e tu tek Krishti i kryqëzuar, dhe falënderoje sepse të ka dhënë rast për t'u rritur në shenjtëri. Gëzohu sepse Krishti të zgjodhi për të bashkëpunuar me të në mënyrë më të ngushtë. Qoftë Ai gjithmonë modeli yt dhe forca jote në kryerjen e misionit tënd fisnik. Amen.

Fjala përshëndetëse e Ipeshkëvit të sapo shuguruar Imzot Gjergj Meta

Në këto raste pritet që ipeshkëvi i ri të mbajë një fjalim programatik. Por unë nuk kam një program që të bëj një fjalim të tillë, pasi programet bëhen kur të kemi shoshitur së bashku me ata që janë në dioqezë situatat, rrethanat dhe pasi të kemi dëgjuar së bashku zërin e Shpirtit që na flet në këto rrethana.

Një gojëdhënë thotë se, jo shumë larg prej këtu, diku në breg të Fanit të vogël, aty ku merr rugën për në Mashtërkorë për me shku drejt Oroshit, në buzë të rrugës së kombit gjernden 12 lisat e Marpepës. Nën ato lisa dikur ishin mbledhur burrat e Spaçit dhe të Oroshit për me diskutu a mund të martohen familjet e tyre me njëra-tjetrën. Ndërsa ata apo kuvendonin aty kalon një grua me emrin Mara e Pepës e cila i përshëndet burrat duke u thënë: "Mirë se rrini vllazën!". Burrat, pasi panë njëri-tjetrin në sy, vendosëm dhe e mbyllën kuvendin, pasi Mara i kishte quajtur vllazën.

Së pari dua t'ju drejtohem juve: *mirë se rrini motra e vëllezër të dioqezës, mirditor, matjanë e dibranë*. Unë jam dërguar te ju. Luteni Zotin së bashku me mua që Fjala të vijë tek ju nëpërmjet shërbesës time. Thuhet se ipeshkvi është dhëndërrri i dioqezës. Unë mendoj se ai është thjesht miku i dhëndërrit, pasi i vetmi dhëndërr i Kishës është Krishti. Të gjithë ne jemi miqtë e tij. Vetëm në miqësinë e ngushtë me të ne do të zbulojmë secili thirrjen tonë.

Së dyti mirë se ju gjej juve vëllezër e motra



meshtarë e rregulltarë. Keni punuar shumë e falenderojmë Zotin. Tani të vazhdojmë punën me zell dhe me entuziazëm të përtërirë. Detyra jonë e parë si meshtarë është shërbesa e Fjalës. Rregulltarët kanë edhe karizmën e tyre, një pasuri, por që nuk duhet të kthehet në pengesë për punën tonë në të mirë të Mbretërisë.

Së treti, mirë se ju gjej juve vëllezër ipeshkëvinj. Sot u bëra pjesë e kolegjit të

Ipeshkëvinjëve. Ky kolegji ka një nga mënyrat e të shprehurit, edhe pse e kufizuar, nëpërmjet Konferencës ipeshkëvore. Jam më i riu ndër ju e do të mundohem të jem njeri i kolegjalitetit me ju dhe në bashkim hierarkik me ipeshkëvin e Romës që këtu përfaqësohet nga Nunci Apostolik. Ky bashkëpunim kolegjal në mënyrat e duhura shtrihet edhe me dy ipeshkëvinjtë e Tivarit e Kosovës, pa lënë në harresë edhe Shkupin,

Kotorrin e në përgjithësi ipeshkvinjtë e ballkanit me të cilët kemi për detyrë dhe mund të jemi vegla paqeje për Ballkanin.

Këtu është edhe Hirësi Andoni, Metropolit i Elbasanit. Faleminderit mik e vëlla që ke ardhur edhe si përfaqësues i Fortlumturisë së tij Keyepeshkopit Anastasios. Prania jote me gëzon pa masë. Edhe pse ka akoma gjëra që na ndajnë, ky mister që kremtuam sot na bashkon.

Dy fjalë përshëndetje për kryetarët e Bashkive që janë këtu. Si e kemi zakon të themi ne në Mirditë: *Paçi faqen e bardhë* që keni ardhë sot. Bashkë mund të bëjmë shumë për të mirën e zonave tona. Në respekt të ndërsjellë mund të jemi partner të mirë për të varfërit dhe zhvillimin e zonave tona.

Më lejoni një mesazh për të rinjtë: Ju jeni energjia e dioqezës sonë dhe e ardhmja e saj. Keni në dorë këtë armë të fuqishme: rininë tuaj, forcën e sidomos dëshirën për të ardhmen. Do të gjeni te unë mbështetje maksimale. Bashkë mund ta bëjmë Kishën tonë dioqezane dhe shoqërinë një vend gëzimi dhe hareje, duke shpallur Krishtin e gjallë mes njerëzve. Faleminderit që keni ardhur sot.

Dy gjëra të fundit: kjo dioqezë është shumë e pasur: ka histori, ka martirët e saj, ka burra dhe gra, të rinj, familje që I japin gjallëri realitetit. Falenderojmë Zotin për këtë.

Njëkohësisht është një dioqezë e varfër materialisht dhe me kler. Për varfërinë materiale janë të mirpritura të gjitha kontributet. Por nga ana tjetër ju them se kjo dioqezë nuk ka nevojë për paratë e atyre që kanë vënë pasurinë e tyre duke

trafikuar vajza e gra për prostitucion, që i kanë shfrytëzuar ato, apo ata që kanë marrë pjesë dhe janë pasuruar me aktivitetet mafioz dhe kriminal, duke vrarë apo duke dhunuar më të dobët, ata që trafikojnë drogë dhe ata që kanë vënë pasurinë e tyre me korrupsion e që kanë blerë pozicionet e tyre me paratë e krimit. Dera e Kishës për këta persona është e hapur vetëm për kthim dhe për pendim. Vetëm atëherë jemi të hapur se si të shikojmë së bashku mundësitë për t'u kthyer paratë vajzave të shfrytëzuara, familjeve të tyre, të varfërve që kanë humbur gjithçka nga padrejtësia e kështu me radhë.

Së dyti ne nuk kemi meshtarë. Së bashku me ipeshkëvin jemi 10 meshtarë. 2 më pak se kolegji i ipeshkvinjëve. Nuk do të jetë kërkimi i meshtarëve shqetësimi im më i madh. Nuk do të kërkoj me ankth meshtarë. Në këtë dioqezë vihet për dashuri ndaj Ungjillit, pasi këtu kënaqësitë e kishave plot, të turmave që na ndjekin nga pas, nuk do të jenë. Këtu vihet për t'i shërbyer Mbretërisë dhe kaq. Vokacionet do të lindin këtu, vetëm pasi ne të dimë t'i kthejmë ungjillin të pagëzuarve, pasi të heqim monopolin klerikal. Çdo misionar këtu është i mirëpritur, me krahë hapur. Nëse nuk do të kenë mundësi jetese, do të jetojnë me mua dhe si mua. Kaq e premtoj. Por asesi kjo dioqezë nuk do të jetë strehë për ata që e shikojnë këtë dioqezë si një kalim apo sepse nuk kanë ku të shkojnë tjetër. Meshtarët këtu do të përzgjidhen dhe për mua nuk vlen ajo shprehja: kalit të falun nuk i shihen dhëmbët. Unë do t'ju shoh dhëmbët atyre që do të duan të jenë meshtarë në këtë dioqezë.

Dëshiroj të falenderoj tre persona ndër të cilët njëri është i gjallë e dy kanë kaluar në amshim. Së pari falenderoj paraardhësin tim Mons Cristoforo Palmieri për punën dhe përkushtimin në këto vite. Faleminderit Monsinjos.

Së dyti, nëse e keni vënë re kam kremtuar meshën me një kelk shumë të thjeshtë. Është dhuratë nga gjyshi im i cili e ka ruajtur gjatë regjimit komunist fshehtas në shtëpinë tonë. Faleminderit atij dhe shumë dëshmitarëve që kanë ruajtur besimin dhe na e kanë trashëguar. E të gjithë ata janë të përfaqësuar sot nga kardinali ynë i dashur Ernest Troshani.

Së treti dëshiroj të falenderoj Imzot Rrok Mirditën. Kryqi që kam sot në këtë kremtim është një nga kryqet që ai ka mbajtur si ipeshkëv. Imzot Mirdita më ka shuguruar daikon dhe meshtar.

Së fundi ju përshëndes të gjithëve. Nëse filloj e përmend emra kam frikë se nuk ia dal dhe harroj ndonjë, të gjallë e të vdekur që më kanë shoqëruar në këto vite.

E fillova këtë fjalim me Marën e Pepës. Një grua e cila, sikurse dihet, nuk kishte të drejtë me marrë pjesë në kuvend me burra, si të gjitha grate e kohës, por që i jep zgjidhje kuvendit. Shpesh ata që janë më të papërfillur e më të pëjashtuar do të jenë këshilltarët e mi më të mirë.

Po e mbyll me një grua tjetër: Marie Tuci. Për të gjithë kam menduar t'ju jap një libër dhuratë. Është biografia e Marie Tucit, shqip dhe italisht. Është bijë e Mirditës, motra jonë, nana jonë. Ajo bashkë me martirët e tjerët na qofshin ndihmë. Rroftë Krishti mbret.

Imzot Giovanni Peragine, Ipeshkëv i Jugut të Shqipërisë.

Homelia e Shkëlqesisë së Tij Imzot George Frendo, në shugurimin ipeshkvor të Imzot Giovanni Peragine si Ipeshkëv i Jugut të Shqipërisë.

Lushnje, më 7 shtator 2017

I dashur vëlla Giovanni: leximet që sapo kemi dëgjuar dhe që ti vetë i ke zgjedhur për këtë rast të veçantë të paraqesin një program për jetën e re që po fillon sot. Sepse sot ti po fillon një kapitull të ri në jetën tënde, me sfida të reja, me aventura të reja. Një kapitull në të cilin Zoti do të të dhurojë shumë raste të bukura për të paraqitur praninë dhe dashurinë e tij.

Në Ungjillin e Lukës lexojmë se një ditë të shtunë Jezusi hyri në Sinagogë dhe atje hapi librin e Isaisë profet, dhe lexoi pikërisht atë pjesë që kemi dëgjuar në Leximin e Parë. Pasi e lexoi, Jezusi tha vetëm këto pak fjalë: "Sot shkoi në vend kjo pjesë e Shkrimit të Shenjtë që e dëgjuat me veshët tuaj." Vetëm kaq ka mjaftuar. Sepse në këtë mënyrë Jezusi, me fjalë të tjera, u tha: Çka ka paralajmëruar Isaia po zbatohet në mua, në jetën time. Fjala e Isaisë shpalli programin e jetës së Jezusit. Por nga





ai Lexim dua të theksoj ato fjalë: “Shpirti më dërgoi të shpall lajme të gëzueshme”. Fjala e Zotit është thelbësisht një lajm i mirë. Ja pse, më përpara, Isaia tha: “Do t’ju jap vajin e gëzimit në vend të zisë, këngën e lavdit në vend të zemrës së trishtuar”. Lajmet e televizorit dhe të gazetave janë plot me lajme të këqija, që na shkurajojnë. Po jetojmë midis një kulture dëshpërimi. Bota ka nevojë të dëgjojë një fjalë që i jep shpresë, kurajo, gëzim. Ky shtë lajmi që bota pret prej nesh, i dashur vëlla, ky është lajmi për të cilin Jezusi po të dërgon si bari në këtë dioqezë. Populli ka të drejtë të dëgjojë prej nesh një fjalë inkurajimi, ka të drejtë të shohë tek fytyra jonë një buzëqeshje. Shenjtja Nënë Terezë e Kalkutës vazhdimisht u thoshte motrave të saj: “Give a big smile! Jepni një buzëqeshje të madhe!” Papa Françesku, në dokumentin e tij mbi Ungjillizimin, thotë se “ka të krishterë, jeta e të cilëve është si kreshmet pa pashkët”. Mos të harrojmë se gëzimi është një nga frytet e Shpirtit Shenjt. Pra edhe Maria, duke ndarë gëzimin e saj me Elizabetën, tha: “Shpirti im me hare i brohoret Hyjit, Shpëtimtarit tim”.

Shën Pali, në Leximin e Dytë, ka shprehur heroizmin e dashurisë së tij ndaj Krishtit. “Kush do të na ndajë nga dashuria e Krishtit?” – thotë ai i cili, vite më parë, i kërkonte nxënësit e Krishtit për t’i futur në burg. Por tashti thotë: “Kur njëri bashkohet me Krishtin, bëhet një krijesë e re”. Dhe ka folur nga eksperiencia vetjake kur ka thënë këto fjalë. Megjithatë në këtë moment dua të të kujtoj, o i dashur vëlla Giovanni, ato fjalë të apostullit në Letrën drejtuar Filipianëve: “Vrapoj që, në ndonjë mënyrë, të mund ta zë, sepse edhe vetë kam qenë zënë prej Krishtit Jezus. Vëllezër, unë nuk mendoj se ia kam arritur; di vetëm kaq: harroj çka kam lënë pas dhe zgjatem drejt të së ardhmes, sulem drejt qëllimit, drejt shpërblimit të thirrjes qiellore të Hyjit në Krishtin Jezus.” Këto fjalë na mësojnë se jetëtonë duhet ta çmojmë si një proces, gjatë të cilit identifikohemi me Krishtin. Por

të kemi kujdes për atë folje që përdor Pali: “zë”. Thotë: “Vrapoj për ta zënë Jezusin, sepse edhe vetë kam qenë zënë prej Krishtit”. Është folje që përdoret për peshkim: peshkatar zë peshq. Nuk e di a ke qenë ndonjë herë për peshkim. (Unë kam qenë vetëm një herë, dhe nuk kam pasur fat... shpresoj të kem më shumë sukses si peshkatar njerëzish!). Për t’i zënë peshqit, peshkatarit përdor një grep, që peshku mos të arratiset. Kështu edhe ne duhet ta zëmë Jezusin në mënyrë që të mos të arratiset. Jezusi tashmë të ka zënë ty, i dashur vëlla. Por ti vazhdo të shkosh për peshkim për Jezusin, që të identifikohesh krejtësisht me të, e fjala jote të bëhet më e besueshme dhe e pranueshme.

Në Ungjill kemi dëgjuar për atë takim shumë interesant të Krishtit të ngjallur me Pjetrin. Jezusi i drejtoi Pjetrit një pyetje të thjeshtë: “A më do ti?” Shën Augustini vëren se Krishti i ngjallur nuk bëri asnjë pyetje tjetër përveç kësaj. Pra ishte një pyetje shumë e rëndësishme.

Sot Jezusi po ta drejton të njëjtën pyetje ty, vëlla Giovanni: “A më do ti?” Dhe pasi të bëhet i sigurt se ti e do, do të të urdhërojë: “Kulloti qengjat e mi”. Këto janë fjalët që ti ke caktuar si moto për stemën tënde: *Pasce agnos meos*. Kulloti qengjat për të cilët sot po shugurohesh ipeshkëv. Së pari me shembullin e jetës sate. Le të shkëlqejë tek ti drita e Krishtit, që të mund të ndriçosh të tjerët. E vazhdo t’i kullotesh me Fjalën dhe me sakramentet.

Dua të përmend se vendi ku është kryer ky dialog mes Jezusit dhe Pjetrit ishte bregu i detit të Tiberiadit, që quhej gjithashtu Deti i Galileës ose edhe Liqeni i Gjenazaretit. Tri vite më përpara Jezusi e kishte takuar Pjetrin, i cili kishte qenë për peshkim tërë natën, por nuk zuri asgjë. Jezusi i urdhëroi: “hidhni rrjetat tuaja për të zënë peshk.” Dhe në fakt zunë një sasi të madhe peshqish. Ky ishte rasti kur Jezusi për herë të parë tha Pjetrit: “Më ndiq mua”; dhe Pjetri e pranoi menjëherë këtë ftesë, ndoshta duke menduar: “Patjetër se do

ta ndjek! Ky burrë do të më sjellë fat!” Tani, Krishti i ngjallur, për herë të dytë i thotë Pjetrit: “Më ndiq mua!” Por tani Pjetri ka kuptuar se ndjekja e Krishtit përfshin gjithashtu eksperiencën e Kalvarit, e kryqit. Dhe kryqi që ti do të mbash mbi kraharorin tënd, i dashur Giovanni, le të të kujtoj se, sikurse tha Dietrich Bonhöffer, nuk ka dishepullat pa eksperiencën e kryqit.

I dashur Giovanni, mos harro se, sipas ligjit të Kishës, ti, që vjen nga një familje rregulltare, nga Kongregata e Klerikëve të Shën Palit, ende je anëtar e asaj familjeje rregulltare, edhe pse jo më i lidhur me kushtin e dëgjësës ndaj eprorëve të Kongregatës. Kjo do të thotë se ti do të vazhdo të përjetosh karizmën e Kongregatës dhe shpirtin e themeluesit të Kongregatës, Shën Anton Maria Zakaria. Të uroj shumë të pasqyrosh shpirtin e tij, veçanërisht dashurinë e tij për të varfrit, devotshmërinë e tij për eukaristinë e shenjtë, dhe angazhimin e tij për të parë një Kishë më të denjë që të quhet “nusja e panjollë e Krishtit”, duke dënuar abuzimet që ishin një njollë për Kishën e asaj kohe.

Dhe së fundi, dua të përmend eksperiencën e bashkëpunimit tim me Atë Giovanni gjatë këtyre njëzet viteve si misionarë në Shqipëri, sepse ai ka ardhur këtu si misionar vetëm pak muaj pasi kam ardhur unë. Gjatë viteve kur unë isha Vikar i Përgjithshëm me Imzot Rrok Mirditën e kam njohur Atë Giovanni shumë nga afër si famullitar në Milot. Më kujtohet kur një ditë shkova me të për të bekuar një kishë mbi një mal. Binte shumë shi, dhe pasi në vendin tim nuk kemi male, gjithmonë kam shumë frikë kur kaloj nëpër rrugë të ngushta mbi male. Kam vlerësuar shumë sakrificat e mëdha të Atë Giovanni-t për të punuar në ato kushte. Kam vlerësuar angazhimin e tij baritor, zellin për të krijuar një bashkësi të krishterë në famullinë e tij. Ja pse, për shumë vite, ka kryer detyrën si dekan i dekanatit verior në dioqezën tonë, dhe kështu ka krijuar edhe një shpirt vëllazëror të fortë mes meshtarëve dhe rregulltarëve të atij dekanati. Kemi bashkëpunuar shumë kur unë isha presidenti i Konferencës së Eprorëve të Lartë dhe ai ishte sekretar i përgjithshëm. Më vonë, në nivel evropian, u zgjodh anëtar i Këshillit Evropian të Konferencave të Eprorëve të Lartë, dhe para disa vitesh edhe presidenti i këtij Këshilli Evropian.

Gëzohu, Giovanni, sepse Zoti të ka dhuruar shumë raste për t’i shërbyer atij dhe Kishës së tij. Po i them këto fjalë, jo që të mburrësh me atë që ke, por për t’u përlulur para Zotit për atë që ke marrë prej tij. Sigurisht, do të gjes mbështetjen dhe bashkëpunimin e plotë tek të gjithë meshtarët dhe rregulltarët shumë të mirë dhe të zellshëm që pasurojnë dioqezën tënde. Vlerëso gjithmonë misionin tënd si ipeshkëv, si një thirrje të veçantë për të shërbyer, sipas shembullit të atij që erdhi në botë jo për të qenë i shërbyer, por për të shërbyer. Ai që, si Barii i Mirë, është takuar me Marinë Magdalenë dhe e thirri për emër, do të të mësojë si t’i njohësh delet e tua dhe t’i çosh drejt atij që është Rrugja, e Vërteta, dhe Jeta, Jezu Krishti. Amen.

Fjala përshëndetëse e Ipeshkvit të sapo shuguruar Imzot Giovanni Peragine

Fort të dashur,

Në këtë moment në zemrën time jehon fort himni i falënderimit të Marisë “Shpirtiim e madhëron Zotin, sepse shikoi me pëlqim shërbëtoreshen e vet të përvuajtur”. Është e vërtetë se përballë madhërisë së Hyjit që vepron në jetën tonë, gjithmonë në mënyrë të papritur e të habitshme ndjej nevojën për atë që është duke kryer në jetën time, pavarësisht prej limiteve dhe dobësive të mia njerëzore. Kemi dëgjuar se Papa Françesku ka dëshiruar, që një misionar nga një qytet i vogël i veriut të Shqipërisë (Milot), të bëhet bari i një territori të gjerë që përfshin Administratën Apostolike në pjesën jugore të Shqipërisë.

Për këtë arsye duhet të falënderoj Papa Françeskun për besimin që më ka treguar, duke më dërguar mes jush si bari të ri. Falënderoj me njëherë hirësinë e tij Mons. Hil Kabashi, i cili për 20 vite e udhëhoqi këtë Administratë. Jam i sigurtë se sakrificat që ai ka bërë, sidomos në vitet e para dhe punët që ai ka bërë deri më sot do të vazhdojnë të japin fryt e edhe në të ardhmen. I përshëndes dhe I falënderoj të gjithë meshtarët dhe rregulltarët që punojnë në këtë Administratë. Besnikëria juaj ndaj Zotit, dëshmia e përditshme dhe heshtja e jetës suaj të kushtuar në shërbim të më të dobtëve, janë e do të jenë për mua arsyeja e inkurajimi në këtë çast dridhjeje.



Të dashur, kam qenë i dërguar nga eprorët e mi si misionar i Kongregatës së Etërve Barnabitë dhe si misionar kam ndër mend të vazhdoj shërbimin tim. Gjatë gati 25 viteve të meshtarisë sime, 20 vjet i kam jetuar këtu në

Shqipëri, në këtë Kishë në mesin e këtij populli, kam mësuar të ushtroj ministerin tim, kam mësuar të dëgjoj njerëzit dhe e kam mbrojtur famullinë time, familjen time. Për këtë e përshëndes dhe e falënderoj bashkësinë e famullisë së Milotit dhe gjithë dioqezin Tiranë-Durrës, e cila për mua ka qenë si një nanë.

Nana Terezë e Kalkutës shpeshherë ka pohuar se ka pasur gjak shqiptar dhe zemër indiane. Edhe unë mund të them padyshim se kam gjak italian dhe zemër shqiptari. Motoja që kam zgjedhur është “Kulloti qengjat e mi”. Ashtu si Pjetri gjatë mundimeve, për tri herë e kishte mohuar Jezusin, pasi kishte kërkuar të konfirmojë dashurinë e tij më shumë se të gjithë, edhe edhe mua Zoti më kërkon t’i kulloso qengjat, popullin e tij, duke filluar nga më të dobëtit më të varfërit, më të largtët.

Me ndihmën e Bariut të mirë dua të bëhem i afërt i dtë gjithëve dhe t’i dëgjoj, udhëheq, mbroj, mbështes e shërbej. I përshëndes, që nga tani, besimtarët e Kishës Katolike, të cilëve së shpejti do t’ju dëgjoj një mesazh përshëndetjeje edhe besimtarët e besimeve të tjera që janë të pranishëm në këtë territor, komunitetin musliman dhe bektashian dhe vëllezërit e kishës ortodokse. Me ta dëshiroj të ndër marr rrugë dialogu dhe bashkimi për të qenë gjithmonë shenjë më konkrete e Hyjit për njerëzimin. Ju përshëndes të gjithëve e lutuni për mua.

Imzot Simon Kulli, Ipeshkëv i Sapës. Homelia e Shkëlqesisë së Tij Imzot Angelo Massafra, në shugurimin ipeshkvor të Imzot Simon Kulli si Ipeshkëv i Sapës.

Vau Dejës, më 14 shtator 2017

Zgjedhja e kësaj date për të kremtuar një shugurim ipeshkvnor është shumë domethënëse: qoftë sepse na jep mundësi të reflektojmë mbi vlerën shpëtimtare të Kryqit të Krishtit, i njëjti që, si flamur, që sot e tutje Dom Simoni do ta mbajë sigurisht me nder në kraharorin, qoftë sepse përmbyll një periudhë hiri që ka parë tre presbiterë të shuguruar ipeshkvij të kësaj Kishë të Hyjit që është në Shqipëri.

E dimë, sakramenti i urdhrin të shenjtë kërkon një përngjasim të veçantë me Krishtin, jo aq në planin e simbolit apo të përfaqësisë, sesa në planin ontologjik. Në të vërtetë, ushtrimi i dashurisë së krishterë, mbarështimi i sakramenteve, ashtu si edhe drejtimi baritor i një pjese të popullit të Hyjit kryhen drejtpërdrejt prej Krishtit nëpërmjet shërbëtorëve të vet.

Plotësia e meshtarisë që dom Simoni do ta marrë pas pak merr rëndësi jo aq për atë





që ai do të bëjë tani e tutje, sesa në emër të “kujt” do t’i kryejë detyrat e tij si ipeshkëv. Prandaj, pikënisja është Jezusi, të cilin ai do ta përfaqësojë për grigjën që i besohet, domethënë Dioqeza e Sapës.

Është Jezusi, i dashur dom Simon, ai Ungjill që të është dorëzuar ditën e shugurimit tënd diakonal, por që sot do të të vendoset mbi kokë dhe do të të mbjerë mbi shpatulla e shpinë: është ai që duhet të të zotërojë tërësisht dhe të të bëjë të fortë në shërbesën që po ndërmer. Në lidhje me këtë, të mos duket e pavend që po citoj shën Agustinin i cili, duke folur për shërbesën ipeshkvnore, e kishte zakon të thoshte se ajo është një rrezik për atë që e merr, sepse e ngarkon me përgjegjësi jo vetëm administruese, por edhe morale.

Shpesh mendohet se të jesh ipeshkëv është nder. Me siguri! Por, sipas shën Agustinit, është nder më i madh të jesh i krishterë. Ndërsa për ipeshkvin nderi rrjedh prej përgjegjësisë që mbart me vete shërbesa. Të dashur besimtarë, kujdesuni për ipeshkvin tuaj: ai nuk i ka zgjidhjet për të gjitha problemet tuaja, por përgjegjësia e tij duhet të kuptohet dhe të bashkëndahet. Afërsia dhe lutja e vazhdueshme për të do të jenë me siguri një ndihmë e vlefshme nga ana juaj. Të dashur presbiterë, jini afër ipeshkvijve tuaj: ditën e shugurimit tuaj e kenit premtuar këtë afërsi dhe dëgjësë birnore. Ipeshkvi ka detyrë të nxisë njësinë në presbiter, por juve ju takon ndërmarrja dhe nisma që të jeni të bashkuar me ipeshkvin tuaj në gjithçka dhe për gjithçka.

Është Jezusi, i dashur dom Simon, ajo Mitër që do të marrësh. Ajo, sipas fjalëve të ritit, të thërret në shenjtërinë e jetës që duhet të shkëlqejë përpara të gjithëve. Por zelli yt drejt shenjtërisë do të jetë vetë Krishti, që e vë në mbrojtje të kokës sate dhe që do t’ua paraqesësh të gjithëve si model dhe udhërrëfyes. Nëse mungon ky zell për shenjtërinë mungon edhe kuptimi i të qenit tonë të krishterë. Çoje grigjën drejt Krishtit dhe bashkoje me të në mënyrë që, duke marrë limfën prej hardhisë, shermendet të shkëlqejnë në fuqi dhe të sjellin fryte.

Është Jezusi unaza që do të të vendoset në gisht: sikurse Krishti është i bashkuar me

Kishën, ashtu edhe ti je i bashkuar me grigjën tënde me një lidhje besnikërie, e njëjta besnikëri që Krishti pati ndaj Atit në kryerjen e misionit të tij shëlbues. “Integriteti i fesë dhe pastërtia e jetës”: kjo, sipas ritit, është domethënia e kësaj unaze që shumë vetë tani e tutje do ta puthin, duke shprehur jo aq për një nderim të personit tënd, sesa për një bashkim të zemrës me fenë e plotë dhe me jetën e pastër që ti përfaqëson.

Pastaj, është Jezusi ai pastoral që do ta shtrëngosh me duar për të mbajtur dhe drejtuar popullin që të është besuar. Vetë Jezusi, në personin tënd, do të jetë i vetmi bari i grigjës. Pikërisht këtu futet edhe reflektimi ynë mbi liturgjinë e sotme, që flet për Kryqin e Krishtit. Në të vërtetë, është Kryqi shkopi pastoral i Jezusit Bariut të Mirë. Me të do t’i biesh Detit të Kuq, simbol i të keqes dhe i mëkatit, për ta bërë popullin tënd të kalojë i pacenuar; me të do të bësh të gurgullojnë ujërat prej shkëmbit, simbol i sakramenteve; vetëm me të do t’i largosh ujërit grabitçarë dhe gjarpërinjtë, që do të duan të përpijnë dhe të helmatisin grigjën; e në fund, tek ai do të mbështetesh për të gjetur përkrahje dhe ngushëllim në momentet e vështira.

Por kryqi, për Krishtin, nuk qe vetëm një mjet torture; ka qenë edhe mjeti me të cilin Ati na ka treguar se çfarë dashurie të madhe ka pasur për botën, deri në atë pikë sa të japë Birin e vet të vetëm për shëlbimin tonë. Kështu na ka mësuar Mësuesi Hyjnor në Ungjillin që sapo shpallëm.

Dom Simon ke zgjedhur kryqin edhe si simbol që spikat në stemën tënde ipeshkvnore: ai këput vargojtë (pranga hekura) që burgosin ata që zgjedhin të dëshmojnë Krishtin e vdekur e të ngjallur dhe ua hap atyre dyert e parajsës, ku do të shkëlqejnë si gurë të çmuar.

Ja çfarë mund të përfaqësojë ende pastorali për ty dhe popullin tënd: një shenjë të qartë të dashurisë së Hyjit i cili shpëton bijtë e vet dhe i çon në jetën e lumtur në amshim. Ji shprehje e gjallë e kësaj dashurie, me forcë dhe ëmbëlsi: mëso e drejto, qorto e shoqëro, por gjithmonë me dashuri.

Dom Simon, i përket Krishtit krejtësisht, lëshoje veten në duart e Tij që Ai të të mbajë

dhe, nëpërmjet teje, të drejtojë popullin kah Ati. Pas disa çastesh do të biesh përdhe’ në shenjë përvujtërie dhe nënshtrimi ndaj vullnës së Hyjit që angazhohesh ta mishërosh çdo ditë. Është e njëjta përvujtëri e Krishtit për të cilën na ka folur Pali apostull në leximin e dytë. Por përvujtëria nuk është qëllim në vetvete, pasi përndryshe do t’i referohej vetes së vet dhe do të ishte e rremë. Përvujtëria të çon tek tjetri, madje tek Tjetri me “T” të madhe: është shenjë që tregon se e ka bërë detyrën e vet në momentin kur Ai që duhej të tregojë është parë dhe ndjekur. Nuk ka gabim më të madh për ne ipeshkvijtë se sa t’i referohemi gjithmonë vetes sonë, domethënë kur funksioni ynë si tregues dështon në qëllimin e vet, duke u ndalur te vetja jonë. Por nëse tregojmë Krishtin, atëherë detyra jonë do të ketë sukses.

Dhe ju, të dashur besimtarë, kur shikoni ipeshkvin tuaj, duhet të dini të shkoni përtej personit të tij dhe të shihni në të vetë Krishtin që vepron. Një fjalë e urtë thotë se “vetëm i marri ndalet të shohë gishtin e atij që është duke treguar hënën”.

Në këtë përvujtëri do të gjendet sekreti i qëllimit të mirë tek i cili me siguri do të çojë shërbesa e dom Simonit; sepse vetëm nëpërmjet përvujtërisë ai do të lërë Krishtin të flasë, do të lërë që Ai të drejtojë, do të lejojë që Ai të bëhet i pranishëm në mbarëshkrimin e sakramenteve që do të udhëheqë, sidomos Eukaristinë.

Eukaristia. Ja pika e fundit e reflektimit tonë, por jo më pak e rëndësishmja; madje, qendra e gjithçkaje. Në Eukaristinë që do të udhëheqësh së bashku me presbiterin tënd dhe popullin e Hyjit, dom Simon, gjendet me të vërtetë plotësia e shërbesës sate ipeshkvnore. Burim dhe kulm i krejt jetës së krishterë, Eukaristia e udhëhequr prej ipeshkvit në njësinë e presbiterit dhe besimtarëve të vet, përbën Kishën, e mbledh atë përreth gurit të këndit, Krishtit Jezus, në mënyrë që Ai të jetë gjithçka në të gjithë.

I kryqëzuar është edhe qendra fizike e të gjitha Eukaristive tona: i vendosur në qendër të asambleve liturgjike, na çon me mendje dhe me zemër te “Ai që e shporuan” për shëlbimin tonë. Ai mbetet gjithmonë një simbol që na bën ta drejtojmë vështrimin tek të gjithë «të kryqëzuarit» e përhershëm: të varfrit, të sëmurët, të moshuarit, të shfrytëzuarit, viktimat e padrejtësisë shoqërore, etj. Ata janë më të denjë për t’u vendosur në «qendër» të meshëve tona. Ashtu sikurse prej Krishtit të kryqëzuar marrim shëlbimin, po ashtu prej këtyre të kryqëzuarve të kohës sonë do të na vijë shëlbimi, në atë masë me të cilën do të dimë të vëmë në jetë fjalën e Ungjillit: “Isha i uritur e nuk më dhatë të ha, isha i etshëm e nuk më dhatë të pi, isha shtegtar e nuk më përbujtët, isha i zhveshur e nuk më veshët, i sëmurë dhe në burg e nuk erdhët tek unë” (Mt 25). Po t’i porosis gjallërisht: le të jenë gurët e çmueshëm të pajës tënde ipeshkëvnore. Shenjta Terezë e Kalkutës, Pajtorja e kësaj Katedraleje, le të jetë modeli yt në këtë veprim dhe vëmendje ndaj të fundëve të shoqërisë dhe fitoftë prej Hyjit për ty një zemër të madhe, të

aftë për t'i pranuar të gjithë, me atë gatishmëri karakteristike të atij që di të dojë.

I dashur dom Simon, të dashur ipeshkvi: ne që jemi prej vitesh dhe ju të rinj të kësaj Kisha të shenjtë të Hyjit që është në Shqipëri, gjatë këtyre 25 viteve kemi marrë një trashëgimi jo të lehtë, atë të shkatërrimit të komunizmit, dhe kemi bërë gjithçka për t'i kthyer kësaj Kisha, domethënë popullit të shenjtë të Hyjit të kësaj toke, dinjitetin e vet të plagosur, por jo të vradë. Tani duam të besojmë se ka ardhur momenti aq i pritur që ta zbukurojmë dhe ta pasurojmë atë me thesaret e katekezës, me shkëlqimin e liturgjisë dhe me angazhimin e një dashurie gjithnjë e më të karakterizuar prej mësimëve të Ungjillit. Një hap përpara është i mundur për lavdinë e Hyjit dhe për të mirën e shpirtave.

Por, së bashku me një trashëgimi dhimbjeje e vuajtjeje, kemi marrë edhe një trashëgimi të shkëlqyer dhe të lavdishme, atë që na kanë lënë Martirët tanë, që Dom Simoni i ka paraqitur në stemën e vet ipeshkvnore. Ata, pikërisht

nëpërmjet fuqisë së kryqit, kanë arritur në lavdi. Jemi të sigurt se tani, prej Qiellit, ndërmjetësojnë për këtë Kishë dhe, me meritat e tyre, janë duke siguruar për ne këtu në tokë një shumësi bekimesh: ju ipeshkvi të rinj jeni prova e gjallë e këtij ndërmjetësimi.

Le të ecim në vazhden e këtyre shembujve të forcës dhe të guximit, sepse sfidat e sotme nuk janë më pak të mundimshme se sfidat e 80 viteve më parë: beteja kundër Ungjillit të Krishtit ndoshta sot është edhe më e pabesë, sepse kundërshtimi ndaj Krishtit nuk është i hapur, por tinëzar. Neve, të cilëve na është besuar kujdesi baritor për popullin e Hyjit, na takon detyra që Zoti i dha Ezekielit profet, ajo e rojtarëve; jo vetëm për të prituri fundin e natës dhe për të lajmëruar ditën, por edhe për të qëndruar zgjuar mbi grigjën dhe për ta ruajtur nga kurthet e armikut. Por, siç u tha më parë, vetëm duke drejtuar vështrimin kah i Kryqëzuarit mund të sigurojmë një ndihmë dhe një mbrojtje të vlefshme.

Nëna e Jezusit, Zoja e Këshillit të Mirë, le të jetë për ty, i dashur Dom Simon, ylli i shndritshëm i mëngjesit, siç e ke paraqitur në stemën tënde, fari i ndritshëm ashtu siç që për Apostujt në Çenakull dhe, që prej këtij momenti, fitoftë për ty një derdhje të përtërirë të Shpirtit Shenjt, ngjashmërinë e përsosur me Krishtin e Kryqëzuar dhe "parresia"-n (guximin e dëshmisë) aq të nevojshme për kryerjen e detyrave të tua.

Edhe ne të gjithë, Kisha e mbledhur në emër të Trinisë, të lëmë në duart e Shpirtit Shenjt, me qëllim që të kryejë në ty vepra të mrekullueshme. Prandaj të përsëris fjalët që më tha Shën Gjon Pali II ditën e shugurimit tim ipeshkëvnor: "Po të lë në duart e Shpirtit Shenjt për misionin që ke për të kryer në Shqipëri". Me gjithë qejf, i dashur dom Simon, po ta kaloj ty po këtë porosi që ti të jesh krejtësisht i zhytur në Hyjin Atë, Hyjin Bir dhe Hyjin Shpirt Shenjt, të cilit i qoftë lavdi e ndera, për të gjithë shekujt e shekujve. Amen

Fjala përshëndetëse e Ipeshkvit të sapo shuguruar Imzot Simon Kulli

Shkëlqesi të nderuara,
I nderuar Nunci Apostolik,
Të dashur vëllezër në Episkopat dhe në meshtari,
Të dashur rregulltar e rregulltare,
Përfaqësues të komuniteteve fetare,
Autoritete shtetërore e civile,
I nderuar kryetari i Bashkisë Vau-Dejës,
Të nderuar miq e dashamir të ardhur nga shumë vende të ndryshme,
Vëllezër e motra në Krishtin.

Falënderoj Atin "I cili dërgoi Birin e vet që kushdo që beson në Të, të ketë jetën e pasosur" dhe më thërret të udhëheq grigjën e tij.

Dhjetë vite më parë në këtë Katedrale u shugurua ipeshkvi Imzot Lucjan Avgustini, çka e bën shumë permalluese për mua këtë ditë, pa praninë e tij fizike, por i sigurt që po lutet e ndërmjetëson për mua e grigjën e tij para Atit. Shembulli dhe zelli i tij si bari do të mbeten të paharruar në mua dhe frymëzues për shërbimin që Nëna Kishë po më beson.

Kur Nunci Apostolik më thirri e më shpalli se Ati i Shenjtë më kishte zgjedhur për Ipeshkëvnor të Dioqezës së Sapës, më ranë ndër mend fjalët e Jeremisë profet: "Ehe, o Zot Hyj! Po, unë nuk di të flas, sepse jam fëmijë!" Por Zoti m'u përgjigj: Mos thuaj: 'Jam fëmijë!' Por shko te të gjithë ata që do të të dërgoj dhe thuaju gjithçka do të të urdhëroj. Mos ki kurrfarë frike para tyre, sepse unë jam me ty për të të mbrojtur (Jer 1,6-8).

Në ato çaste nuk mund të mos kujtoja Marinë, Nënë tonë, e cila me gjithë paaftësinë për të kuptuar misterin që po ndodhte në të, tha "unë jam shërbëtorja e Zotit më ndodhte siç the ti" ashtu unë po shijoj e po habitesha për shikimin e Zotit mbi të vegjlit, po vëreja se si Zoti nuk shikonte denjësinë time apo garancitë që mund t'i ofroja unë, por kërkonte prej meje të lë veten



vegël në duart e tij, të bashkëpunoj me hirin e Tij të bollshëm, siç thotë shën Pali "Të mjafton hiri im, sepse fuqia përsoset në ligësi." (2 Kor 12,9)

Që nga ai moment vazhdoj të lus Shpirtin Shenjt që të më ndriçojë për të kuptuar më mirë, çka kërkon nga unë, e të më dhurojë forcën dhe urtinë që të më aftësojë të marr përsipër e të zbatoj besnikërisht detyrat që burojnë nga shugurimi ipeshkëvnor. Zgjedhja në detyrën e Ipeshkvit për mua është një mundësi e re për t'i shërbyer më mirë Zotit dhe popullit sipas shembullit të Krishtit, që erdhi në botë "për të shërbyer e jo për të qenë shërbyer". Prandaj, ju ftoj të gjithëve, të nxitur nga Dashuria e Krishtit, "Më ndihmoni që t'ju ndihmoj". Do përpiqem të jem plak me pleqtë, i ri me të rinjtë, i vuajtur me të vuajturit, i varfër me të varfërit dhe do të përpiqem të bëhem i ligështë për të ligështët, gjithçka për të gjithë në mënyrë që të shpëtoj ndonjërin. E të gjitha këto

do t'i bëj për dashuri të Ungjillit, kështu që të kem pjesë në të". siç thotë Shën Pali (1 Kor 9, 22).

Dashuria e madhe e paraardhësve të mi për këtë Dioqezë më ka nxitur të pranoj me bindjen dhe fenë e sigurtë se Krishti Bariu i mirë është gjithmonë me mua, t'i prij grigjës drejt kullosave që nuk mbarojnë kurrë, i sigurt edhe në ndërmjetësinë e Shën Terezës së Kalkutës, Martirëve të fesë në Shqipëri, Zojës së Këshillit të mirë, pajtores së Shqipërisë. Atyre dua t'u besoj vetveten dhe popullin fisnik të Sapës.

Dëshiroj të kujtoj bashkë me ju shembullin e fjalët e shën Agustinit, ipeshkëvnor: "Që kur më është dhënë kjo peshë mbi shpinë, për të cilën do t'i jap Zotit një llogari jo të lehtë, jam gjithmonë i trazuar nga shqetësimi për dinjitetin tim. Gjëja më e vështirë në kryerjen e kësaj detyre është rreziku i parapëlqimit të lavdisë personale më shumë se sa shpëtimi i tjerëve. Por nëse nga njëra anë më shqetëson ajo që unë jam për ju, nga ana tjetër më ngushëllon fakti se jam me ju. Për ju jam Ipeshkëvnor, me ju jam i Krishterë. I pari është emri i detyrës që më është dhënë, ndërsa i dyti është emri i hirit".

Më lejoni të shpreh mirënjohjen e thellë para Zotit, për Atin e shenjtë Françeskun, që më besoi udhëheqjen e kësaj kisha dioqezane.

Falënderoj Prindërit e mi, babën e nënën, këtu të pranishëm, që më rritën dhe mbollën në mua dëshirën t'i shërbej Kishës së vuajtur e popullit martir në Shqipëri. Falënderoj Vëllezërit e mi me familjet e tyre, këtu të pranishëm, që i kam patur gjithmonë pranë më lutje e ndihmë për nevojat e mia, gjithë farefisnin dhe të afërmit e mi, miq e dashamir që më kanë përcjellë me lutje e dashamirësi. Një falenderim i veçantë shkon për të afërmit e mi që kanë kaluar në amshim: gjyshërit e mi, Meshtarët që më kanë dhënë shembull me dëshmimin e fesë me jetën e tyre; dom Martin Trushi, dom Injac Dema, dom

Genc Tuku, pader Shtjefën e pader Kostandin Pistulli dhe Mons. Lucjan Avgustinin që më rritën e shoqëruan në thirrjen meshtarake, nga të cilët mësova shumë e mua më mbetet të lutem për ta e të kërkoj ndërmjetësinë e tyre në misionin tim. Dëshiroj të falenderoj të gjithë dioqezën e Sapës, në veçanti besimtarët e Pistullit, ku u linda dhe u rrita, mbi të gjitha një dëshmitare të gjallë këtu e pranishme, e cila më ka pagëzuar, motër Maria Kaleta. Gjithashtu dëshiroj të falenderoj besimtarët e famullisë "shën Nikolli Vau Dejës, ku shërbeva për 14 vite si famullitar. Më keni shoqëruar gjithmonë me lutje, dhe ju lutem vazhdoni të më përcillni që të jem shërbëtor i denjë i grigjës që më është besuar.

Dëshiroj të shpreh mirënjohjen time autoriteteve më të larta kishtarë këtu të pranishëm, ju të dashur vëllezër në episkopat, Shuguruesin tim, imzot Charles Brown, nunc Apostolik, dy bashkëshuguresit imzot Angelo Massafra dhe imzot Dodë Gjergji, i cili që në hapat e parë të meshtarisë sime dhe të rithemelimit të kësaj dioqeze, më ka mbështetur dhe qëndruar afër.

Falënderoj të gjithë meshtarët, rregulltarët e rregulltarët, misionarët e misionaret, seminaristët e pranishëm nga Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, Italia e Gjermania; jeni familje e mrekullueshme që Zoti ka në vreshtin e vet, qëndroni në dashurinë e Tij, e cila na nxit të bëjmë të dukshme fytyrën e mëshirshme të një Ati që na do e na nxit të duam njëri - tjetrin si na ka dashur Ai. Falënderoj për

praninë e tyre miqtë e ngushtë të dioqezës sonë, Arqipeshkvin e Pescarës, Imzot Tommaso Valentinetti, imzot Massimo Camisasca, ipeshkëv i Reggio-Emilia- Guastalla, Imzot Mario Russotto, Ipeshkëv i Caltanissets, Imzot Rrok Gjonlleshaj, Arqipeshkëv i Tivarit, Imzot Zef Gashin, Imzot Dode Gjergjin Ipeshkëv i Kosovës, Imzot Gjergj Frendo, Arqipeshkëv i Tiranë – Durrës, Imzot Cristoforo Palmieri, Imzot Hil Kabashin, Imzot Ottavio Vitale, Ipeshkëv i Lezhës, Imzot Ramiro Moliner Inglez, ish nunc apostolik në Shqipëri, Falenderoj dy Ipeshkëvinjtë e saposhuguruar, vëllezërit e mi në Episkopat, Imzot Giovanni Peragine dhe imzot Gjergj Meta; urime në misionin tuaj të ri! Le të ecim bashkë drejt shenjtërisë dhe në shërbim të denjë të popullit të vuajtur shqiptar.

Miq të shumtë nga Ferrara, Reggio Emilia, altanissetta, Cremona, Bari e nga Gjermania etj.

Falenderoj familjen e dashur Avgustini për praninë e tyre. Falenderoj Provinciale dhe proret e motrave të bashkësive të ndryshme sot të pranishme në këtë katedrale. Falenderoj autoritetet fetare të Kishës Ortodokse dhe të Komunitetit Mysliman, shenjë e dukshme e harmonisë fetare; miq të besimeve tjera të cilët më nderojnë me praninë e tyre në këtë kremtim të gëzueshëm Falenderoj Shtëpinë e Bamirësisë, një prani reale e Kishës në shërbim ndaj më nevojtarëve, të gjithë të sëmurët e të varfërit për praninë e tyre.

Falenderoj autoritetet civile e shtetërore, mbi të gjithë z. Zef Hila, kryetarin e bashkisë Vau-

Dejës për kontributin e tij në mikpritje si zot shtëpie në këtë qytet, dhe të gjithë kryetarët e bashkive të pranishëm në këtë kremtim.

- Në këtë dioqezë ku jam rritur e kam shërbyer, një tokë martire e vaditur me gjak dhe me shembullin e parardhësve të mi, Budit, Bardhit, Mjedës, Serreqit, Kolecit, Thaçit, Prensushit, Volajt, Gjergjit, Avgustinit, dëshiroj të hedh hapat e mi si Bari e t'i ndjek si udhërrëfyes në veprimtarinë time. - Rruga që është hapur përmes martirëve të lumë të kësaj Dioqeze, nga Fran Mirakaj, dom Ndoc Suma, dom Luigj Prendushi dhe atë Daniel Dajani do të jenë edhe gjurma e hapave të mi dhe frymëzim për të harxhuar jetën time në shërbim të Ungjillit, për të bërë të prekshme Dashurinë e Krishtit. - Nga zemra dua të falenderoj të gjithë bashkëpunëtorët e mi, klerin dioqezan të kësaj dioqeze për mbështetjen, afërsinë dhe bashkëpunimin gjatë vitit si administrator dioqezan si dhe komisionet organizative të këtij kremtimi.

- Falenderoj të rinjtë e të rejtat që pa u kursyer kanë organizuar gjithçka, Korin e përbashkët të katedraleve Sapë, Shkodër e Lezhë e shumë të tjerë në punët organizative.

- Së fundi falenderoj të gjithë ju, vëllezër e motra në Krishtin të kësaj Dioqeze, përcillni përshëndetjet dhe bekimet e mia të gjithë atyre që keni në shtëpitë tuaja, sidomos pleqve, fëmijëve, të sëmurëve e të varfërve. Lutuni për mua, që të jem Bari sipas Zemrës së Krishtit.

Faleminderit, Zoti ju bekoftë!

Skëlqesia e Tij Imzot George Frendo në XI vjetorin e shugurimit ipeshkëv

Fjala përshëndetëse e Vikarit të Përgjithshëm të Arkidioqezës Tiranë - Durrës dom Arjan Dodaj kremtimin Eukaristik me rastin e përvjetorit të XI të shugurimit Ipeshkëv të Arqipeshkëvit tonë Sh. T. Imzot George Frendo.

I dashur Arqipeshkvi ynë në Tiranë-Durrës Imzot George Frendo, shumë i nderuar Nunci ynë në Shqipëri Imzot Charls Brown, i shtrejtë Imzot Gjergj Meta Ipeshkvi i Rrëshenit

Të dashur bashkëvëllezër në meshtari, rregulltarë e rregulltare, vëllezër e motra në Krishtin,

Jemi mbledhur për të falënderuar Atin e Mirë në Provaninë Hyjnore, e së bashku ta lusim në këtë Katedrale, Kisha Nënë e Arkidioqezës tonë, ku 11 vjet më parë Imzot George Frendo u Shugurua Ipeshkëv nga duart e të ndjerit Imzot Rrok Mirdita. Sot duam të ngremë himnin e mirënjohjes, për Dhuratën që i ka bërë Arkidioqezës sonë nëpërmjet atërisë së tij, me të cilën na manifeston dashurinë e Bariut të mirë për grigjën që Hyji i ka besuar.

Imzot, këtu ku Hyji ju ka mbjellur, në Arkidioqezën tonë plot gjallëri e rini e në të njëjtën kohë varfëri e vështirësi në shumë periferi, në veçanti ato jetike, ju na sillni shpresën e Krishtit, që është i vetmi Shpëtimtar i Botës, dhe na edukoni të shpresojmë kundër çdo shprese (Rm



4,18), na mësoni që të respektojmë ecjen e të gjithëve, qoftë ajo e thjeshtë apo e ndërlikuar, sepse secili prej nesh ka një histori për të treguar, pasi Hyji Atë i Mëshirshëm, shkruan drejtë pavarësisht nga ne.

Më pak se një vit më parë, Papa Françesku ua besonte ju udhëheqjen e kësaj Arkidioqeze, e pra Atit të Shejtë duam ti themi falënderimin tonë sinqerisht të përzemërt, në personin e Nuncit

Apostolik Imzot Charls Brown këtu i bashkuar me ne në këtë Kremtim.

Imzot Frendo, si sot 55 vjet, bënit veshjen e zhguni të bardhë, në Urdhërin e etërve predikues, të Shën Dominikut, duam t'ju besojmë nën ruajtjen e tij dhe lusim Virgjërën Mari, Zojën e Këshillit të Mirë, Pajtores të Shqipërisë, që të këtë përherë kujdes për Arqipeshkëv tonë, dhe mbarë që ju është besuar!

Homelia e Sh. T. Imzot Gjergj Meta, në përvjetorin e XI të shugurimit ipeshkvor të imzot Sh. T. George Frendo

Të dashur vëllezër motra, rasti i sotshëm, përvjetori i 11^{te} i shugurimit të Mons George-it, na lejon që të reflektojmë së bashku rreth figurës së Bariut në Shkrimin e shenjtë dhe në jetën e kishës. Leximet e meshës janë ngushtësisht të lidhura me njëra-tjetrën, në mënyrë të veçantë leximi i parë, psalmi dhe Ungjilli i Gjonit i sapolexuar.

Po e nis relfktimin tim nga Ungjilli i Gjonit. “Unë jam bariu i mirë” – thotë Jezusi për veten e tij. Ka disa përkthime të kësaj fjale ndërmjet studjuesish të Biblës. Ka prej tyre, si në rastin tonë, që e përkthejnë “bariu i mirë”, ka të tjerë që e përkthejnë “bariu i bukur”, por një nga studjuesit më të mirë të Ungjillit të Gjonit, Raymond Brown e përkthen me fjalët “bariu bujar” ose edhe “bariu model”: “unë jam bariu bujar”, “unë jam bariu model” – thotë Jezusi për veten e tij. Në fakt fjala *bujar* justifikohet nga fjalia që ndjek: *Bariu i mirë e jep jetën për delet e veta*. Po, sepse vetëm nëse je bujar, je në gjendje të japësh diçka. Jo patjetër kush zotëron diçka është në gjendje edhe ta japë atë. Vetëm personi bujar mundet të japë. E bujaria e Hyjit është aq e madhe saqë në dashurinë e tij ai na dha Birin e tij të vetëm. Duke thënë për veten e tij “unë jam” Jezusi duket sikur pohon edhe unicitetin e tij: *vetëm ai në fakt është Bariu i mirë*. Përkundër rrogëtarëve në Ungjillin e Gjonit apo barinjëve të këqinj në librin e Ezekielit, Jezusi na paraqitet edhe si bariu model. Ai është bariu i vetëm, është bariu bujar, por edhe bariu model tek i cili frymëzohen barinjtë që për vullnet të tij janë në krye të grigjës. Cili është kushti për të qenë një Bari i mirë apo bujar? Shën Agustini në komentin mbi Gjonin thotë: *Et pastores ipsi sunt oves*, edhe vetë barinjtë janë dele. Po ashtu në komentin mbi librin e Ezekielit, që ne po lexojmë këto ditë në Liturgjinë e orëve, Agustini i Iponës pohon: “... sigurisht nëse ka dele të mira, do të ketë edhe barinj të mirë; sepse prej deleve të mira formohen barinjtë e mirë. Por të gjithë barinjtë e mirë identifikohen me personin e një të vetmi, janë një gjë e vetme. Në ata që kullostin është Krishti që kullot”. Mund të jesh bari i mirë nëse ke qenë dhe je një dele e mirë. Vetëdija se jemi më së pari dishepuj e më pas udhëheqës, më së pari dele e më pas barinj, na çon drejt një përfundimi të dyfishtë.

Së pari: *Hyji është Bariu i vetëm i popullit të tij*. Sikurse na thotë në leximin e parë Ezekieli: Kështu thotë Zoti Hyj: “Ja unë vetë do t’i kërkoj delet e mia e do të kujdesem për ta. Sikurse bariu që kujdeset për grigjën e vet kur gjendet mes deleve të veta të shpërndara po ashtu unë do të kujdesem për delet e mia. Unë do t’i bashkoj nga çdo vend ku kanë qenë shpërndarë...”. Këtë përfundim Ezekieli e arrin pasi ka folur gjatë për barinjtë e këqinj që nuk kujdesen, madje keqtrajtojnë grigjën. Nuk kanë kujdes për të plagosurën dhe nuk kërkojnë të humburën, nuk janë shenjë bashkimi por përcarje duke shkaktuar kështu shpërndarjen e grigjës. Çdo herë që për arsye të

ndryshme popullit i mungojnë barinjtë e mirë dhe bujarë, apo ata që janë sillen keq me të, vetë Hyji bëhet bari. E kjo na mban me shpresë.

Së dyti: Çdo bari është vazhdimisht në një shkollë, pra është dishepull, dhe frymëzohet te modeli i Bariut bujar. Aspekti i veçantë i Beslidhjes së re, në krahasim me Beslidhjen e vjetër, për sa i përket figurës së Zotit si bari i popullit të tij, është pikërisht fakti se bariu në Beslidhjen e re, e pikërisht në Ungjillin e Gjonit, *jep jetën për delet e tija*. Kjo është një risi në Beslidhjen e re. *Modeli i dashurisë së Krishtit për grigjën e tij nuk është vetëm gadishmëria për të dhënë diçka nga vetvetja, por për të dhënë vetveten*. Vetëm një jetë e dhuruar është një jetë e fituar. Kjo është karakteristika e Bariut bujar e Krishtit: *ai dha jetën për delet e tija*. Nuk ka një dashuri më të madhe se të japësh jetën për miqtë e tu. Në këtë qëndron veçantia e Krishtit si model i bariut për ne meshtarët dhe ipeshkvinjtë: dhurimi i vetvetes deri në fund e krejtësisht. Rezultati i të qenit nxënës nuk është vetëm aspekti i formimit intelektual, i një njohjeje që ka të bëjë vetëm me informacionet mbi Krishtin, por në rastin tonë është shkolla se si të bëhemi të gatshëm për të dhuruar jetën tonë kur ajo na kërkohet, njësoj si Krishti.

Në pjesën e dytë të ungjillit që lexuam bien në sy dy karakteristika të tjera të bariut bujar.

E para: *Ai i njeh delet e veta*. Për çfarë njohjeje bëhet fjalë këtu? Meqenëse në Ungjillin e Gjonit bëhet një identifikim midis Atit dhe Birit “Unë dhe Ati jemi e njëjta gjë” është e kuptueshme që Krishti ka një njohje të brendshme të deleve të tija (vetëm Hyji mund të njohë e të shyrtoj brendësisht, në mënyrë intime) dhe delet që janë në bashkim me të e njohin zërin e tij. Kjo njohje nuk është vetëm një njohje abstrakte, por është një përvojë jete, përvoja që bariu ka me delet e tija: I njeh për emër, një e nga një, njeh jetën e tyre, plagët dhe problemet, gëzimet dhe hidhërimet e secilit e të gjithëve pa përjashtuar askënd. Qëllimi i kësaj njohjeje është që ata të jenë një grigjë e vetme nën një bari të vetëm. Ja pra se si del një aspekt tjetër modeli i bariut të mirë: *marrëdhënia e brendshme që ai ka me delet e tija i përket në mënyrë thelbësore figurës dhe identitetit të çdo bariu*. Shpesh ne jemi me të gjithë e nuk jemi me asnjërin, ose nganjëherë ngushtohemi në grupe të vogla duke u mbyllur e harrojmë të tjerë që ndoshta kanë nevojë shumë për ne edhe pse nuk ndajnë të njëjtat mendime me ne. Bariu i mirë i njeh të gjitha delet dhe rri me ta, me të gjitha bashkë dhe me secilën.

E dyta: “Kam edhe dele të tjera – thotë Jezusi në Ungjillin e Gjonit – që nuk janë të kësaj vathe. Edhe ato më duhet t’i bashkoj dhe do ta dëgjojnë zërin tim...”. Ekzistenca e deleve të tjera që nuk i përkasin vathës nxjerr në pah çështjen e misionit pranë paganëve, një nga problemet e mëdha të bashkësisë së parë të krishterë, por

në të njëjtën kohë e të gjithë kishës në të gjitha kohërat. Jezusi flet edhe për dele që janë jashtë vathës, madje edhe jashtë grigjës. Jezusi gjatë shërbesës së tij ka pasur të bëjë edhe me njerëz të tillë: kujtojmë gruan kananease, kujtojmë centurionin të cilit i shëroi shërbëtorin, gruan samaritanase në Ungjilin e Gjonit, njëri nga të lebsurit e shëruar që ishte i huaj, samaritani i mirë e kështu me rradhë. Edhe këta për Jezusin janë delet e tija. Stili i afrimit të tij me njerëz të tillë që sipas kanoneve të kohës nuk bënin pjesë në popullin e Hyjit, kijonte skandal tek të tjerët. Megjithatë përkundër zërave që e kritikonin Jezusin, ai shpreh me fjalët dhe gjestet e tij vullnetin universal të Hyjit për shëlbimin e të gjithë njerëzve. Misioni i një bariu nuk mbyllet vetëm në grigjën e tij, në vathën e tij, por shtrihet tek çdo njeri. Ashtu sikurse dashuria e krishterë prek të gjithë njerëzit madje edhe armiqtë, ashtu përkujdesja e një bariu shtrihet tek të gjithë njerëzit. Ndoshta këtu duhet të tregojmë pak kujdes në kuptimin e kësaj gjëje. Çfarë do të thotë sot në kontekstin ku ne jetojmë, në Tiranë, Shkodër, Vlorë, e kështu me radhë që ka dele edhe që nuk i përkasin vathës tonë? Ne jetojmë në një ambjent që kulturalisht dhe fetarisht është i shumëllojshëm. Kjo trajtë multifetare dhe multikulturale është një trajtë thelbësore e shoqërisë tonë, madje do të thoja një pasuri.

Ndaj secilit ne kemi për detyrë të shpallim ungjillin, por jo të mendojmë se nëse nuk hyjnë në Kishë për t’u bërë pjesë e saj e nëse nuk bëhen të krishterë do të thotë se janë të humbur. Dialogu edhe me të ndryshmin, në dashuri dhe respekt të ndërsjelltë është një rrugë ungjillizimi, është vetë ky një lajm i mirë. Kujdesi ndaj të varfërve që nuk kanë të hanë, të veshin, të shkojnë në shkollë pavarësisht nga ngjyra e lëkurës apo nga besimi fetar që kanë, është detyrë thelbësore e një bariu. Edhe nëse nuk do të bëhen kurrë katolikë apo as të krishterë, por do të vazhdojnë të jetojnë sipas besimit apo mosbesimit të tyre, kjo nuk i përjashton ato nga përkujdesi ynë. Nuk janë dogmat që na bashkojnë, as të vërtetat abstrakte, por vetëm dashuria.

Shpresoj sadopak të kem kontribuar në kuptimin sa më të mirë të Krishtit si Bariu i mirë e sidomos në përvjetorin e Imzot George-it të përshkruaj trajtat që duhet të karakterizojnë një bari e që, pa dashur të bëj elozhe të sipërfaqta, shpërfaqen në personalitetin e tij dhe në udhëheqjen e tij në këto vite si ipeshkëv ndihmës më parë e tani si ipeshkëv dioqezan.

Megjithatë gjykimi për secilin nga ne i përket vetëm Hyjit e prandaj dëshiroj ta mbyll me fjalët e Shën Palit në letrën drejtuar korintasve: “...gjithkush le të na mbajë për shërbëtorë të Krishtit e për mbarështues të mistereve të Hyjit... Sa për mua nuk jam aspak në kujdes se më gjykoni ju apo çfarëdo gjyqi njerëzor. Por as vetë nuk e gjykoj veten..., sepse gjykatësi im është Zoti”.

Mons. Henricus Veldkamp Kapelan i Atit të Shenjt

Sipas dokumentit nga Selia e Shenjtë i cili mban dt. 18 Gusht 2017, Ati Shenjtë Papa Françesku Kancelarin e Dioqezës sonë, Don Henry Veldkamp, e shpalli Kapelan të Atit të Shenjtë sigurisht edhe duke e shuguruar edhe Monsinjon. Në meshën festive të 11 vjetorit të shugurimit të Arqipeshkvit Mons. Gjergj Frenko, u bashkangjiti edhe ky event festiv. Mons. Henry Veldkamp në përshëndetjen e tij tha:

Shumë i nderuar Monsinjon Gjergj, sot 11 vjet ipeshkëv, dhe shumë i nderuar Monsinjon Charles, Nunci Apostolik, shumë i nderuar Mons. Gjergj Meta, ipeshkvi i Rrëshenit, shoku im i ngusht që prej 25 vitesh, shumë i nderuar Mons. Giovanni, Administrator Apostolik i Jugut të Shqipërisë, të nderuar vëllezër meshtarë dhe Motra, të dashur besimtarë!

Eshtë një nder i madh të quhesh 'Kapelan i Atit të Shenjt'. Dikush ka filluar ta mendoj se ky do të jetë një titull i përshtatshëm për Don Henrin. Dikush i zgjuar, dikush i vëmendshëm dhe i dashur. Ky person mund të jeni vetëm ju, Monsinjon Frenko, nismëtari i kësaj kërkese në Vatikan, për të cilën ju keni gjetur Nuncin Apostolik bashkpunëtor të gatshëm dhe të efektshëm. Ju e dini rrugën! Me qenë se Monsinjon Charles ka ardhur mes nesh vetëm para një kohe të shkurtër, bëhet pyetja "çfarë i keni thënë ju, çfarë i keni treguar ju Nuncit për t'ia mbushur mendjen, që të kërkohet ky emërim prej Papës"! Megjithatë mirënjohja ime duhet të shkojë së pari tek Ati i Shenjt, i cili më ka konsideruar të denjë – edhe pse s'jam – për t'u quajtur mbas sotit 'Monsinjon'! Kurr nuk do të mësohem! Prapëseprapë shumë faleminderit, sepse kështu po e ndjej bindjen se këto njëzet vjet që qëndroj tek Kuria e Arqidioqezës Tiranë-



-Durrës nuk ishin të kota. Dhe kjo bindje është e barabartë me bindjen, që Krishti nuk ka vdekur kot për ne, miqtë e Tij! Premtoj para Popullit të Zotit, që do të bëj çmos të jetoj për rritjen e Kishës këtu në tokën e Shqiptarëve, t'i çoj besimtarët në lartësitë qiellore për lavdinë e amshuar! Krishti më ndihmoftë! Zoja më ndihmoftë!



Dekret për shpalljen e Sinodit të Arqidioqezës Tiranë–Durrës

IMZOT GEORGE FRENDO O.P.

ARQIPESHKËV METROPOLIT I TIRANË-DURRËS

TË GJITHË MESHTARËVE, RREGULLTARËVE, RREGULLTAREVE DHE BESIMTARËVE

Fort të dashur, përshëndetje në emrin e Zotit tonë Jezu Krishtit!

Tashti kanë kaluar më shumë se nëntë muaj nga ajo ditë kur, në Kishën tonë Katedrale, u lexua Dekreti i Atit të Shenjtë Françesku, me anën e të cilit më kishte caktuar Arqipeshkëv të kësaj Arqidioqeze të dashur të Tiranë-Durrësit.

Dua të rrëfej se, në fillim, kisha shumë frikë se, për faktin se jam i huaj, nuk do të pranohesha nga populli si Arqipeshkëv në kryeqytet; dhe kisha frikë se, për faktin se jam i shtyrë në moshë, nuk do të pranohesha nga të rinjtë. Por kam gabuar! Sepse në fakt populli ynë shqiptar, i njohur për shpirtin e tij jashtëzakonisht mikpritës, më ka pranuar me një dashuri të madhe. Gjithashtu të rinjtë, jo vetëm më kanë pranuar me gëzim, por më kanë ndihmuar në mënyrë që, në sajë të dashurisë së tyre, sot ndihem më i ri sesa isha para një viti!

Falenderoj Zotin për ju: Ai më ka dhuruar një familje të madhe, që jeni ju. Dhe falenderoj ju, të dashur besimtarë, që më tregoni një respekt që, më besoni – flas sinqerisht – nuk e meritoj. Falenderoj meshtarët tanë, që, me një kujdes me të vërtetë baritor, bashkëpunojnë ngushtë me mua me një besnikëri të madhe. Falenderoj murgeshat, që me një përkushtim të pamasë, zhvillojnë punë të ndryshme për të mirën e popullit tonë. Falenderoj besimtarët, që e duan Kishën me një dashuri bijësore. Gjatë vizitave baritore që kam bërë deri tani në disa famulli kam vënë re se Arqidioqeza jonë është shumë e pasur,

jo sigurisht në kuptimin financiar, por është e pasur në personat shumë bujarë në dashuri dhe solidaritet, shumë të fortë në dëshminë e fesë, shumë të gatshëm për shërbim.

I nisur nga këto vëzhgime, kam menduar sesi mund të rritemi si një familje që ushqehet me Fjalën e Zotit, që bashkohet rreth sofrës së Krishtit Shpëtimtar, dhe që shquhet për dashuri. Me fjalë të tjera, si mund të rritemi si një bashkësi, familje, që pasqyron Krishtin profet, prift dhe mbret. Dhe, pasi u konsultova me Këshillin Meshtarak dhe me Këshillin Baritor, vendosa të planifikojmë dhe përgatisim një Sinod Dioqezan, që do të jetë i pari në dioqezën tonë.

Por duhet t'ju tregoj çfarë është një Sinod Dioqezan. Dokumentat e Kishës e përkufizojnë: "Sinodi dioqezan është asamblea e meshtarëve dhe besimtarëve të tjerë të dioqezës, të zgjedhur për t'i dhënë ndihmë ipeshkvit dioqezan për të mirën e të gjithë bashkësisë dioqezane" (kan. 460). Prandaj në Sinod do të marrin pjesë jo vetëm Arqipeshkvi dhe meshtarët, por edhe një përfaqësim të motrave dhe të laikëve.

Një Sinod nuk bëhet në një ditë ose në një javë. Përfshin shumë takime dhe kërkon një përgatitje të gjatë. Pasi u konsultova me Këshillin Meshtarak dhe me Këshillin Baritor, vendosa që ky Sinod të hapet zyrtarisht në tetor 2018. Ndërkohë kemi një vit gjatë të cilit dëshiroj që të gjithë meshtarët, motrat, dhe besimtarët tanë të luten për suksesin shpirtëror të Sinodit dhe të reflektojnë mbi thirrjen e Zotit që na fton të

pranojmë me gëzim Fjalën e Tij. Sepse Fjala e Zotit është gjithmonë një lajm i mirë që na nxit të angazhohemi për të ndërtuar një shoqëri më të denjë për popullin tonë, më vëllazërore, më pasqyruese e dashurisë së Krishtit.

Dhe duke pasur parasysh dy dokumenta të mëdha të Kishës në epokën pas Konkilit të II^e të Vatikanit, *Shpallja e Ungjillit* të Papa Palit VI, dhe *Gëzimi i Ungjillit* të Papa Françeskut, pasi u konsultova me bashkëpunëtorët e mi, vendosa që tema themelore e Sinodit të jetë *Ungjillëzimi i Ri në Arqidioqezën tonë*.

Në përgatitje për Sinodin, do të organizohet një Asamble Dioqezane më 7 tetor të këtij viti, tek Qendra Dom Bosko. Fillojmë në orën 9.30 fiks. Të gjithë besimtarët tanë janë të ftuar dhe të nxitur të marrin pjesë në këtë Asamble.

Urdhëroj që ky Dekret të lexohet në të gjitha kishat e Arqidioqezës në të gjitha meshat që do të kremtohen sot pasdite dhe nesër paradite dhe pasdite. Dhe nxis të gjithë besimtarët t'i luten Hyjit Krijues, Zojës Mari, Yllit të Ungjillëzimit, dhe Shën Palit, Pajtorit të Arqidioqezës sonë, për suksesin shpirtëror të Sinodit.

E dhënë sot, e shtunë 23 shtator, në përvjetorin e njëmbëdhjetë të shugurimit tim ipeshkvor, tek Kurja jonë arqipeshkvo.

George Frenko O.P.

Arqipeshkëv Metropolitan i Tiranë-Durrësit

Mons. Henry Veldkamp

Kancelar